



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:042224

Datë: 20.06.2019

Numri i dokumentit: 00370022

P.nr.27/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtari Shaqë Curri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku në lëndën penale kundër të pandehurit I N, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit, nga neni 358 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1496/16, të dt. 29.12.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.20.05.2019 dhe 17.06.2019, në prani Prokurores se shtetit Suada Hamza, të pandehurit I N, me dt. 17.06.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.20.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

I N, i biri i V dhe nënës GJ, e gjinisë Daci, i lindur me dt. ..., në fsh. SH i Madh, K. Pejë, tani me vendbanim në Pejë, Lagja, identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion – vozitës, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. tel. ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

Konform nenit 363 par.1 nën par 1.1 të KPPK-së.

REFUZOHET - Aktakuza

Gjëja se:

I pandheuri I N

Me datë 17.06.2016 gjatë ditës në fsh. Shtupeq i Madhë, në vendin e quajtur "Bjeshka e Shtupeqit" pronë e të dëmtuarit Isa N, me qëllim vjedhje ka bërë prerjen e pesëmbëdhjetë (15) drunjëve teknik te llojit "Breu" me vëllim të përgjithshëm prej 3.55 m³, gjersa me dt. 18.06.2016 i pandehuri nga ana e policisë i pandehuri është hasur duke i transportuar trungjet për në shtëpinë e tij të cilat i kishte ngarkuar në automjetin e tij të llojit kamion "V" me targa të regjistrimit ..., të cilat edhe janë konfiskuar.

- me çka kishte për të kryer veprë penale, vjedhja e pyllit nga neni 358 par 1 të KPRK-së.

Për shkak të heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barre të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

I dëmtuari Isa N për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1496/16, të dt. 29.12.2016, i pandehuri I N, është akuzuar për për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit, nga neni 358 par.1, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin gjyqësor me datë 20.05.2019 dhe 17.06.2019, ne te cilën kane qene te pranishëm Prokurorja e Shtetit Suada Hamza, dhe i pandehuri I N

Pas shqyrtimit te provave ne fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit nder te tjera ka deklaruar se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe dëgjimin e dëshmitarëve R M, si dhe policit Bashkim Atashi, si dhe raportin e përpiluar nga pylltari M M dhe tekniku pyjor R M, si dhe nga deklarata e pylltarit M M nga seanca e kaluar , konstatohet se personat e lartë cekur kanë dal në vend të ngjarjes, ku është konstatuar se masa prej 1.48 m³, është prerë në pyllin e I Nt, ndërsa vëllimi për masën tjetër drusore prej 2.07 m³, nuk është konstatuar vendi i prerjes për shkak të terrenit të papërshtatshëm dhe pamundësisë së konstatimit të vendit të prerjes. Andaj në prezencën e këtyre rrethanave dhe meqenëse masa prej 1.48 m³, për të cilin është konstatuar vendi i prerjes nuk i plotëson elementet e figurës së veprës penale, nga neni 358 par.1, të KPRK-së, tërhiqet nga ndjekja penale dhe heq dorë nga aktakuza PP/II.nr.1496/16, të dt. 29.12.2016, kundër të pandehurit I N

Andaj gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse prokurorja e shtetit hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr.1496/16, të dt. 29.12.2016,dhe nga ndjekja penale ndaj të pandehurit I N

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Konform nenit 463 par 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i dëmtuari Isa N udhëzohet në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
P.nr.27/17 me datë 20.06.2019

Sekretarja Juridike

Gjyqtari

Fitore Bojku

Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.